



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.1420/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d), Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2026 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Raportin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.02.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1392/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 neni 12.2 shkronja (d), 17 shkronja (b) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008) , Ligji Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme neni 4, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 11, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2026 merr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË PRONËS TË PALUAJTSHME

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës me Nr. P-73317036-00133-3 në sipërfaqe prej 433 m² zona kadastrale Hani i Elezit me kulturë tokë jopjellore, për ndryshe pronë private e z.Driton Ramadan Luri me vendbanim Hani i Elezit.
2. Kjo parcelë planifikohet për ndërtimin e tregut të gjelbërt për shitjen e produkteve bujqësore nga fermerët lokal të Komunës.
3. Prona e shpallur si interes i përgjithshëm publik në pikën 1 të këtij vendimi do të shërbej ekskluzivisht për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik .
4. Duke ju referuar nenit 1 të këtij vendimi, ekzekutimin e mëtutjeshëm të shpronësimit do ta kryen ekzekutivi i komunës sipas procedurave ligjore.
5. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës

Hani i Elezit
Data: 26. 02. 2026





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.1404/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 neni 30, Ligji Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike neni 17, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 52, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2026 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2026 PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR NPL "PASTRIMI" SH.A HANI I ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e biznesit për vitin 2026 për Ndërmarrjen Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave N.P.L "PASTRIMI" SH.A Hani i Elezit.
2. Plani i biznesit për vitin 2026 për Ndërmarrjen Publike Lokale përmban gjithsej 21 (njëzet e një) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- N.P.L Pastrimi SH.A,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.02.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

